



Në bazë të Nenit 22 pika 1.20 e Statutit të FSHK-së, Kryesia e FSHK-së në mbledhjen e mbajtur me datën : 18.02.2025 , shqyrtoi dhe miratoi:

KRITERET PËR ZGJEDHJEN E PËRZGJEDHËSIT TË PËRFAQËSUESES SË SHTETIT NË SHAH

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Për të kryer detyra të veçanta/specifike, Kryesia mund të zgjedhë dhe shkarkoj organet e përkohshme për të kryer këto detyra. Zgjedhja e organeve të përkohshme bëhet me propozimin e Kryesisë dhe ka mandat deri në përfundimin e një detyre të veçant të deleguar.

Neni 2

Emërimi i organit të përkohshëm për zgjedhjen e Përzgjedhësit/es të përfaqësueses së shtetit në shah bëhet me votën e shumicës së anëtarëve prezent të Kryesisë. Ky organ përbëhet nga Kryetari dhe dy (2) anëtarë të bordit. Vendimet meren me shumicë votash dhe ato i verifikon Kryesia në mbledhjen e saj të ardhshme. Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në punën e ketyre organeve si fasilitues, por nuk e ka të drejtën e votimit.

Neni 3

Kriteret për zgjedhjen e Përzgjedhësit/es të përfaqësueses së shtetit në shah janë:

- 1) të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës ose shtetas i huaj;
- 2) të jetë anëtarë/e i/e FSHK-së, ECU-s apo FIDE-s;
- 3) të jetë nën moshën 70 vjeç/e dhe i/e aftë për punë(e preferuar) ;
- 4) të jetë punëtorë/e i/e respektuar shahu apo shahist/e ;
- 5) të ketë përvojë minimum 15 vjeçare në lojën e shahut;
- 6) të ketë titull të shahistit/es apo Fide ELO mbi 2200 pikë(jo obligative);

- 7) të njohë njërën nga gjuhët zyrtare të FIDE-s : anglisht, frengjisht, gjermanisht ose rusisht;
- 8) të ketë titull të trajnerit/es, minimum Instruktor/e FIDE, (jo obligative);
- 9) të mos jetë i/e larguar apo i/e suspenduar më herët nga FSHK;
- 10) të mos jetë i/e dënuar për vepra penale.
- 11) të mos jetë i/e dënuar ligjërisht për ndonjë vepër penale e cila bie ndesh me ligjet ndërkombëtare;
- 12) të paraqes plan-programin e tij/saj ne formë të shkruar;

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e Përzgjedhësit /es të përfaqësueses së shtetit në shah janë:

- a) Të përcaktoj kriteret për përzgjedhjen e reprezentacionit të Kosovës;
- b) Të përpiloj planin (2)+(2)-vjeçar të pregaditjes së reprezentacionit;
- c) Të raportoj te Kryetari i Federatës dhe te Kryesia për punën e tij/saj në baza vjetore;

Neni 5

Përzgjedhësi/ja i/e përfaqësueses së shtetit në shah në mungesë rezultatesh apo për shkak të mos-realizimit të plan-programit mund të shkarkohet me shumicë votash nga Kryesia e Federatës në çdo kohë.

Neni 6

Kriteret e njëjta të zgjedhjes dhe shkarkimit të Përzgjedhësit /es të përfaqësueses së shtetit në shah aplikohen edhe me rastin e zgjedhjes së Përzgjedhësit/es tek femerat si dhe tek të rinjtë.

Këto kriteret për zgjedhjen e Përzgjedhësit/es të përfaqësueses së shtetit në shah janë miratuar në Kryesinë e Federatës të mbajtur më datën:

Prishtinë, 18.02.2025

KRYETARI I FEDERATËS

z. Armend Budima


